



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5335 Prot.

Tiranë, më 1.12. 2022

URDHËR

NR. 710, DATË 1.12. 2022

PËR

**NJOFTIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, NË KËSHILLIN KONSULTATIV PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME, MËNYRËN E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE AFATIN E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “e”, të pikës 2, të nenit 17 të ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, të pikës 3, të Kreut III, të vendimit nr. 541, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përzgjedhjes të anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e këshillit konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Përzgjedhja e kandidatëve për përfaqësuesit e IAL-ve në Këshillin Konsultativ të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 541, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përzgjedhjes të anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”.
3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, për përfaqësues të IAL-ve në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme është data 15.12. 2022.
4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për përzgjedhjen e përfaqësuesve të IAL-ve në Këshillin Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin,

Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Evis KUSHI**

